

SA MINERALE TREGTON SHQIPËRIA?

Një vështrim për pagesën e Taksës Kombëtare të Rentës për mineralet e Hekur Nikelit të nxjerra, si tregues për vlerën e vlerësimin e mineraleve Shqiptare që eksportohen jashtë vendit.

nga Artan MIRASHI – Auditues i Lartë, Brunilda ZENELI – Audituese e Lartë,
botuar në gazetën “Koha Jonë”, më 13 maj 2015.



Pak histori. Rezervat totale të Hekur Nikelit në Shqipëri janë rreth 215 milionë ton. Në vitin 2012, çmimi i tij i shitjes si mineral është në nivelet e 30-35 USD/ton, në një kohë që çmimi i nikelit si metal është në nivelet e 18.000 USD/ton (në metalurgji duhen rreth 125 ton mineral Hekur Nikeli me 1 % Nikel në përmbajtje për 1 ton metal Nikeli). Kuptohet çfarë përfitimi do të ishte sikur të shitej si produkt metal, nëse do të kishim industri përpunimi. Investime të tilla, për nxjerrjen e metalit nga minerali shkojnë në vlera që i kalojnë 100 milionë USD (sipas botimeve shkencore), nikeli që ka Shqipëria, deri më sot, vetëm është “gërvishtur”.

Shfrytëzimi i mineralit të hekur-nikelit shqiptar ka filluar në vitin 1957 në minierën e Pishkashit, me vonë ka vazhduar në minierat Përrenjas - Guri Kuq – Bitinckë, etj.

Mineralet e hekurit të Shqipërisë gati janë me cilësi të veçantë, të ngjashëm me disa vendburime të Rusisë, Australisë, Kaledonisë së Re dhe Kubës dhe quhen minerale lateritikë të hekur-nikelit. Veçantia qëndron në përmbajtjen e nikelit, kobaltit dhe kromit - elementë që në funksion të llojit të produktit që kërkohet të përftohet - janë të dobishëm ose të dëmshëm, por që kanë influencë të madhe në kostot e prodhimit, pra në normën e fitimit.

Deri në vitin 1992, minerali i Hekur Nikelit eksportohej kryesisht në Çekosllovakia në një sasi prej 500.000 ton/vit dhe përpunohej nga Kombinati Metalurgjik në një sasi prej rreth 700.000 ton në vit. Për periudhën mbas 1992 nuk ka statistika të rregullta për nxjerrjen e përpunimin e këtij minerali. *(referuar botimeve për mineralin e hekur-nikelit nxjerrjen e përpunimin e tij në vend)*

Aktualitet ligjor: Koncepti i Rentës Minerare në ligjin nr. 7796, datë 17.2.1994 "Ligji mineralar i Shqipërisë" në nenin 51 të tij përcaktohet *një rente pasurie minerare (royalty) prej 2% të vlerës së tregut për sasinë e përgjithshme të mineralit të shitur tek konsumatorët gjatë muajit kalendarik dhe të prodhuar nga zona e përcaktuar në lejen minerare pagesa e cilës përcaktohej me Rregullore.*

Në aspektin ligjor ky koncept në Ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për Sektorin Mineralar në Republikën e Shqipërisë", në nenin 40 të tij për Rentën përcaktohet se: *Renta minerare është detyrim i zotëruesve të lejeve*

minerare. Trajtohet si taksë kombëtare dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit e Njësive Vendore përkatëse. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 4.1.2012 janë përcaktuar rregullat e dokumentacioni i nevojshëm për llogaritjen e arkëtimin e Taksës Kombëtare të Rentës Minerare.

Deklarimet në eksport. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar pagesën e detyrimeve fiskale Rentën Minerare, për mineralet e nënprodukte të tyre të nxjerra dhe të eksportuara. Në eksportin e mineralit të Hekur Nikelit, në degët doganore e kryesisht në Degën e Doganës Qafë Thanë çmimet e shitjes së mineralit për eksport janë deklaruar dukshëm të ulta, krahasuar me çmimet e tregjeve ndërkombëtare. Kjo ndikon direkt jo vetëm në llogaritjen e vlerës së rentës minerare por edhe në deklarimin e të ardhurave në eksport e për pasojë edhe në deklarimin e të ardhurave e të treguesve të tjerë financiarë e tatimorë.

Në vitin 2013 totali i eksportit të Mineralit të Hekur Nikelit arrin në rreth 192 mijë ton, nga te cilat më kryesoret nga Dega e Doganës Qafë Thanë janë eksportuar rreth 134 mije ton dhe nga Dega e Doganës Morinë Kukës janë eksportuar rreth 52 mije ton.

Në vitin 2014 totali i eksportit të Mineralit të Hekur Nikelit arrin në rreth 390 mijë ton, nga te cilat më kryesoret nga Dega e Doganës Qafë Thanë janë eksportuar rreth 327 mije ton dhe nga Dega e Doganës Durrës janë eksportuar rreth 56 mije ton.

-Për artikullin Mineral Hekur Nikeli të eksportuar, renta minerare është llogaritur sipas deklarimit të subjekteve në nivelet rreth 8- 9 \$/toni pa

përfshirë transportin në destinacion (FOB sipas inkotermave të transaksionit).

Vlera e tregjeve ndërkombëtare sipas burime të publikuara (çmime e tregje) për periudhën 2013-2014 për Mineralin e Hekur Nikelit me përmbajte nikeli të afërt me Mineralin e Hekur-Nikelit që nxirret në vendin tonë, variojnë nga 34\$/ton deri 43 \$/ton FOB.

Konstatime: Vlerësimi dhe pranimi i çmimit të shitjes së deklaruar nga subjektet të Mineralit Hekur Nikelit në momentin e shitjes për eksport është dukshëm në nivelet rreth 4 herë më poshtë se tregjet ndërkombëtare. Niveli i ulët i deklarimit të çmimit të shitjes në eksport ndikon në uljen e nivelin e arkëtimit të Taksës Kombëtare të Rentës Minerare dhe në treguesit e tjerë financiar e fiskal. Për këtë llogaritur në bazë të eksportit të këtij minerali vetëm për Doganën e Qafë Thanës që në këtë rast është në rolin e agjentit tatimor për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të ardhurat e arkëtuara nga Taksa Kombëtare e Rentës Minerare për mineralin e eksportuar nga kjo degë doganore në vitet 2013 e 2014 janë më të ulta, për rreth 57,835 mijë lekë. Në legjislacionin në fuqi përcaktohet se Administrata tatimore dhe ajo doganore kanë detyrë të kontrollojnë saktësinë e deklarimeve të bëra nga subjektet bazuar në çmimet e tregut për nënproduktet që shiten apo eksportohen (në bazë të të dhënave nga bursa, ose informacione të tjera), gjë e cila nuk ka ndodhur.

Për diferencën në arkëtimin e të ardhurave prej 57,835 mijë lekë (të ardhura të munguara në Buxhetin e Shtetit) nga mos deklarimi i çmimit real të shitjes për arkëtimin e detyrimeve nga Renta Minerare. Kontrolli i Lartë i Shtetit,

nisur nga konstatimet dhe nga e drejta ligjore ka dalë me Vendimin e Kryetarit nr. 53, datë 30.04.2015. Në Vendim i rekomandohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, që në zbatim të ligjit, duhet të paraqesë e publikojë zyrtarisht vlerën e tregjeve të mineraleve për mineralet e Hekur Nikelit të eksportuar. Në përputhje e në zbatim të tyre degët doganore të bëjë llogaritjen e Borxhit Doganor për Taksës së Rentës Minerare dhe të rillogariten e arkëtohen detyrimet për rentën minerare bazuar në ligj e në çmimet e publikuar sipas tregjeve.

Duhet një ndërgjegjësim në radhë të parë nga institucionet shtetërore përgjegjëse si Ministria e linjës, AKBN, DP Doganave e DP Tatimeve për azhurnimin e publikimin e çmimeve të shitjes së mineralit në tregje ndërkombëtare, me qëllim për një vlerësim real të pasurive të vendit tonë si dhe vjeljen e taksave Kombëtare në nivelin e caktuar nga legjislatori. Këtu ka vend edhe për një rishikim të nivelit të këtyre taksave, që realisht janë më të ulta se shumica e vendeve të tjera.